

PANDELI SOTIRI, PERSONALITET I SHQUAR I SHKOLLËS SHQIPE

Pandeli Sotiri ka lindur në vitin 1843 në fshatin Selekë të Lunxhërisë. Ndikim të madh në formimin e personalitetit të tij kishte periudha kur ndoqi mësimet në Normalen greke të Qestoratit. Këtu, ai mori mësimet në gjuhën shqipe fshehurazi, nga Koto Hoxhi. Humbja e prindërve, si rezultat i vrasjes nga kusarët, bëri që ai dhe vëllai i tij, Koto, me ndihmën e një kushëriri, të vendosen në Vjenë të Austrisë. Aty, pasi mbaroi shkollën e mesme, vazhdoi studimet e larta në fushën e mjekësisë. Me të mbaruar studimet dhe me të marrë diplomën e mjekut, ushtroi profesionin për pak kohë në Vjenë. Në vitin 1870, Pandeli Sotiri u largua nga Austria dhe u vendos në Stamboll, në kryeqendrën e Perandorisë Osmane. Këtu, nëpërmjet Koto Hoxhit, u njoh me vëllezërit Naim e Sami Frashëri si dhe me Kostandin Kristoforidhin etj. Pandeli Sotiri ka qenë një nga 28 patriotët që themeluan në Stamboll Shoqërinë e të "Shtypurit të Shkronjave Shqip". Kjo shoqëri e pa dritën e saj të themelimit në shtator të vitit 1879, pra pak kohë pasi në Prizren më 10 qershor 1878, ishte mbledhur dhe themeluar Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Shoqëria e të "Shtypurit të Shkronjave Shqip" u quajt prej disave me emërtimin "Drita", sipas emrit të së përkohshmes, që do të niste të botohej më vonë.

Botimi i librave shqip ishte një nevojë e domosdoshme për shkollat shqipe, që mendohej të hapeshin në viset shqiptare. Mirëpo botimi i librave shqip në Stamboll haste në vështirësi nga mosmiratimi i tyre prej autoriteteve turke, si dhe nga ndikimi i patrikanës greke të Stambollit. Prandaj Pandeli Sotiri bashkë me Jani Vreton u dërguan në Rumani, ku ishte një koloni e njohur shqiptarësh. Dërgimi i Pandeli Sotirit dhe Jani Vretos, dy intelektualë dhe veprimtarë të shquar, në atë vatër me aq rëndësi i dha shtysë forcimit të degës së shoqërisë së Stambollit për të

“Shtypurit të Shkronjave Shqipe”, degë e cila më datë 24 dhjetor 1884 u pagëzua me emërtimin “Drita” dhe me një statut të ri. U mbledhën rreth 15000 franga, një shumë, e cila ndihmoi në ngritjen e shtypshkronjës së Bukureshtit, që luajti rol të madh në botimin e letërsisë së Rilindjes, të librave për shkollat shqipe, si dhe të botimit të disa gazetave e revistave shqiptare (fletoreve shqiptare).

Veprimtaria në gazetari e Pandeli Sotirit si drejtues i revistës “Drita” - “Dituria”

Revista “Drita”, e themeluar për të vënë në jetë programin e “Shoqërisë së të Shtypurit të Shkronjave Shqip” e pa dritën e botimit në Stamboll më 10 gusht 1984. Ajo pati në fillim si drejtues Petro Pogën, një lunxhëriot nga fshati Erind. Duke filluar nga numri 2, revista “Drita” do të drejtohej nga një tjetër lunxhëriot, nga Pandeli Sotiri, të cilit i ngarkuan si detyrë që, më parë se përbajtjen e lëndës së revistës ta dorëzonte për shtyp, ta dërgonte për miratim në Ministrinë e Arsimit të Perandorisë. Pandeli Sotiri, si drejtues i revistës “Drita”, duke filluar nga numri 4 ia ndryshoi emërtimin në “Dituria”, duke vazhduar kështu deri në numrin 12, kur e përfundoi aktivitetin kjo revistë.

Revista “Drita”-“Dituria” luajti rol të madh në zgjimin dhe zhvillimin e ndjenjave atdhetare dhe kombëtare ndër shqiptarët. Ajo përhapri njohuri të ndryshme shkencore-natyrore dhe shoqërore-kulturore, në veçanti botoi shkrime për Shqipërinë dhe lënda e saj shërbeu për tekstet e para shkollore shqipe.

Pandeli Sotiri, ndonëse kishte kryer studime të larta për mjekësi, në drejtimin e revistës “Drita”-“Dituria”, me kulturën dhe horizontin që zotëronte, e tregoi veten një gazetar i mirëfilltë.

Peshën kryesore në shkrimet e botuara në këtë revistë e mbajnë vëllezërit Sami e Naim Frashëri, Jani Vreto, Pandeli Sotiri dhe Koto Hoxhi. Revista, me shkrimet e botuara, ndihmoi për përhapjen e alfabetit të Stambollit dhe të mësuarit në gjuhën shqipe. Dhe Jeronim de Rada, me të marrë numrat e parë të saj, do të shkruante: “Ajo ka për qëllim t’u njoftojë djemtë të Shqipërisë së shkretë, ato që dihet sot nëpër kombet e zhvilluara, përderisa kjo të ketë shkollat e saj”.

Pandeli Sotiri- drejtor i Mësonjëtores Shqipe Kombëtare të Korçës, që u hap më 7 mars 1887

Në fushën e arsimit kombëtar, si mësues e drejtues i Mësonjëtores Shqipe Kombëtare të Korçës, të hapur më 7 mars 1887, Pandeli Sotirit ka merita të veçanta. Vetë fakti që Pandeli Sotiri u zgjodh drejtues i shkollës së parë shqipe kombëtare të Korçës tregon për rolin e tij si mësues, si organizues e drejtues i arsimit në veçanti dhe atë atdhetar në përgjithësi.

Duke kthyer vëmendjen në historikun e hapjes së Mësonjëtores Shqipe Kombëtare të Korçës, mësojmë se në vitet '80 të shekullit XIX, qyteti i Korçës paraqitej si epiqendër e sillogut grek, i cili kishte dërguar në qytet shumë mësues dhe kishte çelur shkolla greke. Duke iu referuar statistikave të kohës, mësojmë se në qytetin e Korçës kishte 3 shkolla në gjuhën turke, 4 shkolla në gjuhën greke, ndër të cilat një gjimnaz grek, një shkollë vllahe e themeluar në vitin 1885 dhe një shkollë bullgare, themeluar më 1891. Pra, Korça, e banuar nga popullsia shqiptare, nuk kishte asnjë shkollë zyrtare shqipe.

Në vitin 1885, pak kohë para se në Korçë të hapte dyert Mësonjëtorja Shqipe Kombëtare, Nikolla Naço, një ndër anëtarët më aktivë të shoqërisë "Drita" të Bukureshtit, ndërmori 4 udhëtime për në Stamboll me pseudonimin Joanidhis. Pasi denoncoi me shkrim pranë Pallatit të Sulltanit intrigat dhe veprimtarinë antishqiptare të patrikanës së Stambollit, të klerit fanariot dhe të mësuesve të shkollave të huaja, kërkoi që në shkollat dhe në kishat ortodokse të Shqipërisë të futej gjuha shqipe në vend të greqishtes. Por kjo kërkesë mbeti pa përgjigje.

Rilindësit tanë të mëdhenj, me përpjekjet e tyre për mëvetësinë e kombit, i dhanë rëndësinë e duhur ndriçimit të mendjes të popullit shqiptar, me anën e arsimit dhe shkollimit. Ishin përpjekjet e përbashkëta të atdhetarëve të Korçës, të Bukureshtit, të Stambollit e të Egjiptit, për të hapur shkollën shqipe kombëtare të Korçës, që u harmonizuan në disa drejtime: një palë të përgatisnin opinionin në qytet, të tjerët të siguronin lokalitetin si dhe ndihmat për nxënësit e varfër, kuadrin mësuesor etj. Tekstet u përgatitën nga Sami e Naim Frashëri, Pandeli Sotiri etj.

Vështirësitë që u hasën në Korçë, ku prefekti i qytetit u përpoq të pengonte hapjen e shkollës shqipe, ku edhe forca prapanike ishin zotuar që nuk do të lejonin hapjen e një shkollë të tillë, nuk e penguan hapjen e shkollës së parë shqipe të Korçës. Shkolla u vendos të hapej në shtëpinë që dhuroi veprimtari i shoqërisë “Drita” të Bukureshtit, Diamanti Terpo. Dhe Pandeli Sotiri la punën e tij vetjake, dhe porsa merr lejen e Ministrisë së Arsimit të Perandorisë “për të çelur shkollë private në gjuhën shqipe në Korçë” me një torbë të mbushur me abetare dhe libra u nis dhe erdhi në qytet, ku me 7 mars 1887 hapi shkollën e parë shqipe. Pandeli Sotiri që vinte në drejtim të Mësonjëtores Shqipe Kombëtare të Korçës, ishte një personalitet shqiptar i pajisur me kulturë të gjerë, njohës i mendimit filozofik, letrar, shkencor e pedagogjik francez, austriak, italian etj.

* * *

Dita e përrurimit të shkollës shqipe të Korçës u kthye në një ditë feste të vërtetë. Në shkollë kishin ardhur 35 nxënës, së bashku me prindërit e tyre. Përveç vëllezërve Pandeli e Koto Sotiri, aty ndodheshin edhe shumë atdhetarë e veprimtarë të lëvizjes kombëtare, si: Jovan Cico Kosturi, Orhan Pojani, Thimi Marko etj. Përpara nxënësve, prindërve dhe pjesëmarrësve të tjerë, i pari e mori fjalën drejtori i mësonjëtores, Pandeli Sotiri, i cili falënderoi nënat, baballarët dhe bijtë e tyre për gatishmërinë që treguan. Pastaj ai u foli për rëndësinë e mësimin në gjuhën shqipe dhe të shkollës, që po hapej atë ditë. Pas tij e morën fjalën edhe të tjerë pjesëmarrës në përrurimin e shkollës.

Të nesërmen e kësaj ngjarjeje, më 8 mars 1887, Thimi Markoja u shkruante shqiptarëve të Bukureshtit : “...Dëshira tona u mbarua, shkolla shqipe u hap, druri që vumë në dhet këtu e dy vjet, sot lulëzoi dhe dha pemë të ëmbla....”. Ndërsa poeti i madh i rilindjes sonë, Naim Frashëri, i entuziazmuar nga çelja e Mësonjëtores, i kushtoi asaj poezinë “Korça”:

O vallezër shqiptarë:
Gëzohi që erdh kjo ditë,
Kaq e mir e kaq e mbarë.
Që sjell gjithë mirësinë.

.....

Lumja ti, moj Korç' o lule!
Qi le pas shoqet tua,
Si trimi në ball u sule,
Ta paçim për jetë hua.

Në fazën e parë, mësonjëtorja kishte katër klasë, përveç klasës përgatitore. Lëndët kryesore ishin: Shkrim dhe lexim shqip, gramatikë e gjuhës shqipe, mësohej edhe turqishtja si gjuhë zyrtare e perandorisë. Më vonë u shtuan edhe gjuhët frëngjisht dhe greqisht. Për njëfarë kohe në mësonjëtorë jepte mësim vetëm Pandeli Sotiri. Nga 35 nxënës, arriti të kishte rreth 60 nxënës, kurse në vitin e dytë rreth 200 nxënës. Nga ana financiare, shkolla mbahej me ndihmën e korçarëve patriotë si dhe të shqiptarëve të kolonisë së Bukureshtit.

Për të përballuar nevojat urgjente që paraqiteshin, Pandeli Sotiri dha një shembull të bukur në zgjidhjen praktike të kuadrit arsimor. Kështu, ai zgjodhi për mësues ndihmës, një nga nxënësit më të mirë të shkollës, Thanas Sinën, i cili zotëronte greqishten dhe shqipen, pasi edhe një pjesë e nxënësve, që vinin në shkollën shqipe të Korçës, vinin nga shkolla greke.

Si drejtues i shkollës shqipe të Korçës, Pandeli Sotiri tregoi aftësinë e tij edhe në organizimin shkencor të shkollës, duke e përhapur përvojën e tij në shkollat e tjera, që u hapën atë vit shkollor e pak më vonë, si në Pogradec, shkollë e cila u hap një javë më vonë nga i vëllai i Pandeli Sotirit, Koto Sotiri, si dhe për shkollat që u hapën më pas në Kolonjë, Berat, Gjirokastër etj. Është drita që u ndez në Korçë, e cila po përhapej në të katër anët e atdheut.

Pandeli Sotiri, në kohën që drejtoi shkollën e Korçës, hodhi baza për një punë didaktike të kualifikuar duke i mësuar kolegët mes të tjerave edhe me shembullin e tij si mësues i gjuhës shqipe.

Në Mësonjëtorën e Parë Shqipe të Korçës filloi të zhvillohej edhe një veprimtari intensive në fushën shoqërore e kulturore. Ditën e diel, për shfrytëzim aktiv të kohës së lirë, organizoheshin orë të veçanta me ligjërime, këngë të bukura, duke ftuar edhe prindërit. "Të dielën, - tregonte një nxënës, - Ai (Pandeli Sotiri) na mblidhte në sallë e na mësonte këngë shqip, vjersha dhe i ftonte prindërit tanë të dëgjonin fëmijët. Kur këndoheshin këngë

e bëheshin recitime nga fëmijët, prindërit emocionoheshin aq shumë, sa edhe nuk mbanin lotët”. Ndërsa një nxënës i Pandeli Sotirit tregon vargjet që i ka mësuar mësuesi i dashur dhe i nderuar:

*Vëllezër shqiptarë,
Lidhuni me dashuri!
Erdhi koha e mësimit,
Të fitojmë dituri!*

Shoqëria e Mësimit Shqip në Korçë dhe Pandeli Sotiri

Hapja e Mësonjëtores Shqipe Kombëtare të Korçës u shoqërua edhe me krijimin e Shoqërisë së Mësimit Shqip në Korçë, ku Pandeli Sotiri luajti rolin kryesor në themelimin dhe veprimtarinë e saj. Kjo shoqëri kishte 160 anëtarë me besime të ndryshme të krishterë dhe muslimanë. Në këtë shoqëri bënin pjesë figura, të tilla si: Pandeli Sotiri, Vani Cico Kosturi (Jovan Kristo Kosturi), Orhan Pojani, Thoma Arvani, Kristo Mitkua, Ali Babani, Thanas Sina etj. Kjo shoqëri bëri një punë të madhe me komunitetin në bashkërendimin e punëve mes pjesës muslimane e të krishterë duke marrë pjesë së bashku si në shkollën e re të krijuar, ashtu dhe në shoqërinë e re për të mësuar gjuhën amtare, sipas kërkesave të kohës duke përdorur alfabetin e Stambollit. Kjo ishte një veprimtari politike, arsimore dhe kulturore, e cila gëzonte mbështetjen e mirë të shoqërisë patriotike të mërgimit, sidomos të asaj të Bukureshtit, të Stambollit dhe të Egjiptit.

Jeta e Pandeli Sotirit u shua nga një aksident i kurdisur

Dhespoti i Korçës, Filotheus Kostandinidhis, u shqetësua shumë nga hapja e shkollës shqipe të Korçës. Ai mallkoi jo vetëm mësuesit e kujdestarët e shkollës, por edhe prindërit dhe nxënësit duke u ndaluar priftërinjve të kryenin pagëzime, kurorëzime e varrime në familjet e tyre. Por kjo nuk ishte e gjitha.

Puna e Pandeli Sotirit u bë një pengesë serioze e forcave antishqiptare, të cilët organizuan edhe zhdukjen e tij.

Pandeli Sotiri ishte martuar me një grua greke nga lagjja Fanar e Stambollit. Kisha ortodokse greke, për të luftuar drejtuesin

e parë të shkollës shqipe, Pandeli Sotirin, kishte arritur me mënyrën e saj dinake të bënte për vete edhe të shoqen e tij. Ajo u përdor si për largimin e tij të shpejtë nga Korça, ashtu edhe për përgatitjen e vdekjes. Nën presionin e të shoqes, Pandeli Sotiri e la detyrën e drejtorit të “Mësonjëtores Shqipe Kombëtare” të Korçës, në mes të vitit të dytë shkollor dhe vajti për të jetuar në Stamboll. Shkolla mbeti nën drejtimin e Thanas Sinës. Dhe më pas drejtimin e mori Petro Nini Laurasi e më në fund Nuçi Naçi.

Pandeli Sotiri në Stamboll gjeti një vdekje aksidentale të tmerrshme, kurdisur nga e shoqja dhe vjehri, të cilët e hodhën nga dritarja e banesës trekatëshe në rrugë. Kështu u shua jeta e këtij pionieri të Rilindjes Kombëtare.

Pandeli Sotiri është dekoruar me titullin e lartë “Mësues i Popullit” me motivacionin: “Për merita të shquara në përpjekjet për pavarësinë e Atdheut dhe për punë të palodhur në përhapjen e gjuhës amtare dhe zgjerimin e shkollës shqipe”.

Literatura e përdorur:

1. Mësuesit për kombin shqiptar, Musa Kraja. Botimet “Toena”, viti 1993.
2. Bij të Lunxhërisë për arsimin shqiptar (Pandeli dhe Koto Sotiri), Musa Kraja, Tiranë, 2002.
3. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës / Instituti i Studimeve Pedagogjike: Historia e arsimit dhe mendimit Pedagogjik shqiptar, Vëllimi I, Tiranë, 2003.
4. Enciklopedia shqiptare, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në 3 vëllime, botim i vitit 2008, vëll. 1 dhe 2, botimi i vitit 2009, vëll. 3.
5. Mësonjëtorja Shqipe e Korçës / Arsimi popullor, Nr. 3, mars 1961, fq. 131-147, Gaqo Peci